

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“FACCIATE” SH.P.K

Sot, më datë 31/07/2023, në Tiranë,

Znj. Eva Sula, shtetase shqiptare, lindur më 27/09/1987, në Tiranë, Shqipëri dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur kartë identiteti me nr 175927010S, lëshuar nga Republika e Shqipërisë, më dt.08/04/2014,

E cila ka vendosur themelimin e shoqërisë **FACCIATE SH.P.K.**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

SHOQËRINË TREGTARE **FACCIATE SH.P.K.**, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim *Shoqëria*).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare perfaqesimi dhe agjenci në shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**FACCIATE**”.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Projektim- furnizimi dhe zhvillimi i Fasadave të Ventiluar për objekte civile dhe industriale. Ndërtim i objekteve civile dhe industriale, ndërtimi i ndërtesave, zyrave, rrugëve, hekurudhave, porteve, aeroporteve, veprave energjetike, kanalizimeve dhe çdo veprë tjetër ndërtimi. Përfshihet riparimi dhe restaurimi i këtyre objekteve; Prodhim, përpunim lëndesh të para dhe produktesh të ndryshme, përfshirë energjinë dhe hidrokarburet; Import, eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vetë shoqërisë, apo të tretëve të materialeve të ndërtimit, produkteve ushqimore dhe industriale, makinerive, pajisjeve e pjesë këmbimi të tyre, të energjisë dhe hidrokarbureve, lendeve të para, produkteve të gatshme e gjysem të gatshme, mineraleve; Import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të skrapit dhe metaleve. Transport kombëtar e nderkombëtar në rrugë detare, tokësore, apo ajrore; Riparimin e makinerive të ndërtimit dhe mjeteve rrugore për nevojat e shoqërisë dhe të tretëve; Konsulencë në fusha të ndryshme, supervizion, menaxhime, studime e projekte të të gjitha llojeve, vlerësime tekniko - ekonomike, konsulencë dhe ndërmjetësim për lidhje dhe



zbatim kontratash, marreveshjesh te ndryshme, ortakerish, shoqerish te perbashketa apo forma te tjera, veprimtari komisionere, perfaqesim, si dhe veprime te tjera te porositura nga te tretet te lejuara nga legjislacioni shqiptar; konsulence, revizion, ekspertize, vleresime te kapitaleve dhe gjendjes se shoqerive, projekte zhvillimi dhe studime. Tregti me shumice dhe pakice, import eksport te artikujve te ndryshem industriale, materiale ndertimi, inerte, parafabrikate, hidrosanitare, ndertim, montim, vegla auto, makineri e pajisje pjese kembimi, etj. Gjithashtu, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj shërbimi apo aktiviteti Projektimi dhe ndërtimi fasadë e ventiluar dhe konsulencë, që i lejohet një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë së saj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Linze, Pasuria nr. 200/14-N7, ndodhur ne zonen kadastrale 2460, Tiranë, Shqipëri.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është 1 (një) kuote. Themeluesi merr ne pronesi kuoten e tij në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tij.

Kontributi i ortakut themelues ne kapitalin themeltar është si më poshtë:

Znj. Eva Sula , 1 kuote , me vlerë 100 Lek, zotëron 100 % (njëqind perqind).

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Aktivitete tregtare mbyllen në datën 31 dhjetor të çdo viti. Aktiviteti i parë tregtar do të mbyllet në datën **31 dhjetor 2023**.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm;
2. Administratorët.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë **znj. Eva Sula**, shtetase shqiptare, lindur më 27/09/1987, në Tirane, Shqiperi dhe banuese në Tirane, Shqiperi, person madhor



me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur karte identiteti me nr I75927010S, lëshuar nga Republika e Shqipërisë, më dt.08/04/2014,
Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.
Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative që:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues dhe dispozitave të legjislacionit shqiptar.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortaku i vetëm, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12.

Shoqëria "FACCIATE" SHPK fillon veprimtarinë e saj me nënshkrimin dhe miratimin e dokumenteve të saj të themelimit, dhe me regjistrimin e saj në QKR.


NENI 13.

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 2 (DY) kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortaku Themelues i cili e gjeti atë në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe e nënshkroi pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES

Znj. EVA SULA

 EVA SULA